



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402004/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve Gjirokastër.*

Drejtuar: **Z. Flamur BINE**
Kryetar i Bashkisë

G J I R O K A S T Ë R

Për dijeni: **Z. Aranit MUHO**
Drejtore i Shtëpisë së të Moshuarve

G J I R O K A S T Ë R

Në vijim të inspektimeve në Qendrat e Përkujdesjes Shoqërore, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, më datë 03.11.2014, inspektuan Qendrën e të Moshuarve, Gjirokastër.

Ky inspektim u krye në mbështetje të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe vecanerisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

"Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise".

Në takimin e bërë me drejtuesin e kësaj qendre, u informuam se aty trajtoheshin persona të moshuar duke filluar që nga mosha 60 vjeç, por kishte edhe katër të moshuar të moshës 55 vjeç. Gjithashtu 30% e të moshuarve ishin me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore. Aktualisht strehoheshin 45 të

moshuar, nga 55 që është kapaciteti i kësaj qendre. Në këtë qendër strehohen të moshuar nga rrethe të ndryshme të vendit.

Personeli i kësaj qendre përbëhej nga 21 punonjës. Punonjësja sociale kishte dosje të veçanta për çdo të moshuar, me të dhënat për acurinë e tyre. Shërbimi mjekësor realizohej nga një mjek me part-time.

Kuota ushqimore prej 300 lekë në muaj për çdo person që trajtohet në qendër ishte e mjaftueshme

Në ambiente të veçanta ishin të afishuara rregullorja e brendshme dhe standartet që duhet të respektonin punonjësit e qendres. Kutia e ankesave hapej në çdo fund muaji, në prani të përfaqësueses nga Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Gjirokastër, ku mbahet edhe një proces-verbal.

Organizoheshin vazhdimisht aktivitete të ndryshme, rite fetare, ekskursione në Sarandë, Tiranë etj, festat e fundvitit etj. Çdo të premtë të moshuartit organizojnë festa. Nga donatorë organizohen festa fetare apo zyrtare, ditëlindje, etj.

Monitorimi i standarteve bëhej shpesh nga inspektorë të Shërbimit Social Shtetëror, nga Inspektoriati Punës, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Gjirokastër, Drejtoria e Higjienës, etj.

Kjo qender përbëhej nga një godinë tre katëshe. Ishtë kryer rikonstrukcioni i saj gjatë vitit 2013-2014 me fondet e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

Është për tu theksuar fakti se në këtë qendër tregohej një kujdes i madh në drejtim të pastërtisë dhe të rregullit. Që në hyrje të qendrës vihej re kjo pastërti dhe mbizotëronte një atmosferë e ngrohtë mirëkuptimi ndërmjet të moshuarve dhe personelit të qendrës. Të moshuaret femra ndodheshin në katin e tretë të ndërtesës, ndërsa meshkujt në katin e dytë. Të gjitha ambientet ishin në kushte shumë të mira dhe të mobiluara. Kati i parë më parket. Ishtë bërë restaurimi i shkallëve dhe kangjellave të brendshme prej inoksi gjatë këtij viti. Në ambientet ku mbaheshin mallrat ushqimore, artikujt hotelerike, veshmbathjet etj, çdo gjë ishte e sistemuar dhe në vendin e caktuar. Lidhur me zbatimin e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, kjo realizohet nga mjetet e vendosura në një kënd të caktuar dhe stafi ishte i tranuar, madje ishte ngritur edhe një komision për këtë qëllim.

Gjatë bisedës me të moshuarit, ata shprehnin mirënjohje për ndaj punonjësve të qendrës.

Vlen për t'u vlerësuar puna e palodhur dhe me përkushtim i Drejtuesit dhe stafit të qendrës, për kujdesjen dhe shërbimin cilësor ndaj të moshuarve.

Gjatë këtij inspektimi, u vunë re problematikat e mëposhtme:

- Ngrohja realizohej me gaz dhe me rezistenca në çdo dhomë. Ngrohje qendrore nuk kishte. Ishtë bërë një projekt për vitin 2015.
- Në organikën e punonjësve të qendrës nuk ka psikologë. Është kërkuar zëvendësimi i sociologut me psikolog.
- Në këtë qendër kishte 4 të moshuar të paralizuar, që kanë nevojë të vazhdueshme për seanca fizioterapie, por nuk kishte salla për kryerjen e këtij shërbimi.
- Një problem shqetësues ishte edhe ajo e mjekut part-time, pasi të moshuarit janë me probleme shëndetësore të ndryshme dhe kanë nevojë që mjeku të jetë tërë kohës i pranishëm në qendër.

- Nuk kishte shofer dhe makinë. Për transportimin e të moshuarve në spitale apo komisionet mjekësore, rezervohet taksia.

Sa më lart, në kuadrin e decentralizimit të shërbimeve shoqërore, duke qenë se kjo qendër është nën administrimin Tuaj sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.850 datë 15.12.2006 *“Për transferimin në pronësi, disa bashkive, të pronave që janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, dhe për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave në.60 datë 01.02.2006 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Shërbimit Social Shtetëror”*, për t’iu përgjigjur sa më shumë nevojave të personave me aftësi të kufizuara në këtë qendër dhe për të plotësuar një nga standartet e shërbimit të përkujdesit shoqëror në Institucionet Rezidenciale, siç është pasurimi i rrjetit të shërbimeve dhe rritja e cilësisë së tyre, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për:

1. Mundësinë për shtimin në organikë me psikolog, mjek me kohë të plotë, dhe shofer.
2. Ngritjen e një salle fizioterapie.
3. Funksionimin e ngrohjes qendrore.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, ku thuhet se,

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI